BASHKIA TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
KRYETARI

40212
Nr._____prot.

Datë 11.11.2026

DREJTUAR: **Zt. Taulant BALLA**

Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

PËR DIJENI: **Zt. Niko PELESHI**

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Zt. Mathiu MORI

Sekretar i Përgjithshëm i Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës

Trupit Diplomatik të Akreditуar në Republikën e Shqipërisë

LËNDA: Kërkesë për inicimin e ngritjes së një komisioni hetimor parlamentar mbi kërcënimet dhe ndërhyrjet e Kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama, ndaj kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe përdorimit të institucioneve peniteciare për shantazh politik, institucional dhe njerzor.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 13, 70, 77, pika 2, 80 dhe 115 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8891, datë 2.5.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", i ndryshuar; si dhe nenet 3 dhe 8 të Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore, ratifikuar me ligjin nr. 8548, datë 11.11.1999.

I nderuar z. Balla,

Ju drejtohem në cilësinë time si Kryetar i zgjedhur i Bashkisë Tiranë dhe anëtar i organeve drejtuese të Partisë Socialiste, për t'i kërkuar, nëpërmjet Jush, Grupit Parlamentar Socialist ushtrimin e funksionit kushtetues të kontrollit mbi pushtetin ekzekutiv, përmes inicimit të një komisioni hetimor parlamentar. Kërkesa lidhet me rrethana të një rëndësie të jashtëzakonshme kushtetuese: transferimin tim nga IEVP Durrës në IEVP Fier dhe kërcënimet që deklaroj se më janë përcjellë personalisht nga Ministri i Drejtësisë, z. Toni Gogu, në emër të Kryeministrit Edi Rama, për të më detyruar, nën kërcënimin e rëndimit të pozitës sime penale dhe kushteve të

paraburgimit, të pranoj organizimin dhe financimin e protestave dhe të jap dorëheqjen nga mandati i Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

Më 28 tetor 2026, u transferova nga IEVP Durrës në IEVP Fier, pa më njoftuar arsyet e këtij vendimi dhe pa më vënë në dispozicion aktin përkatës, duke më privuar nga mundësia për të ushtruar efektivisht të drejtën e ankimit. Dy ditë më vonë, më 30 tetor 2026, rreth orës 22:30, në institucionin ku mbahesha i paraburgosur, u paraqit personalisht Ministri i Drejtësisë, z. Toni Gogu.

Gjatë takimit, ministri më deklaroi shprehimisht se transferimi dhe izolimi im ishin urdhëruar personalisht nga Kryeministri Edi Rama. Në emër të tij, më përcolli kërkesa të shoqëruara me kërcënimin e rëndimit të pozitës sime penale dhe kushteve të paraburgimit, me qëllim që të pranoja se unë isha organizatori dhe financuesi i protestave studentore dhe të jepja dorëheqjen nga mandati i Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Komunikimi përfshiu gjithashtu kërkesa që ndërhynin në ushtrimin e të drejtave të mia procedurale dhe në marrëdhënien me mbrojtësit e mi ligjorë.

Paraqitja e Ministrit të Drejtësisë, në orët e vona të natës, në institucionin ku mbahesha i paraburgosur, për të më përcjellë në emër të Kryeministrit Edi Rama kërkesën për pranimin e një fakti të pavërtetë dhe dorëheqjen nga mandati i Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ngre një çështje që shkon përtej kompetencave dhe përgjegjësisë individuale të ministrit. Duhet të hetohet autoriteti më i lartë i pushtetit ekzekutiv i cili ka përdorur varësinë institucionale të administratës penitenciare, për të ushtruar presion ndaj një të zgjedhuri vendor, me qëllim ndikimin në qëndrimin e tij procedural dhe dorëzimin e mandatit.

Këto zhvillime duhen shqyrtuar edhe në lidhje me përpjekjen e mëparshme të Kryeministrit për ndërprerjen e mandatit tim. Me vendimin nr. 66, datë 3 nëntor 2025, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi vendimin e Këshillit të Ministrave për shkarkimin tim nga detyra e Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Kërkesa për dorëheqje, që Ministri i Drejtësisë deklaroi se ma përcillte në emër të Kryeministrit Edi Rama, fakton vazhdimësinë e të njëjtit objektiv politik përmes mjeteve të tjera. **Çështja që duhet të hetojë Kuvendi është nëse, pasi rruga institucionale e shkarkimit u mbyll nga Gjykata Kushtetuese, Kryeministri ka përdorur autoritetin e tij mbi ekzekutivin dhe administratën penitenciare për të arritur, nëpërmjet shantazhit për dorëheqje, rezultatin që nuk mundi ta realizonte me vendim qeverie, neutralizimin tim politik.**

Këto rrethana ngrenë një çështje të mirëfilltë të kontrollit kushtetues mbi pushtetin ekzekutiv. Sipas nenit 12, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar", kompetenca për autorizimin e klasifikimit të informacionit nga titullarët e institucioneve të tjera i përket Kryeministrit. Për rrjedhojë, nëse akti i transferimit tim nga IEVP Durrës në IEVP Fier është klasifikuar ligjërisht si "sekret shtetëror" nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ky klasifikim ka si burim të drejtëpërdrejtë autorizimin e Kryeministrit Edi Rama.

Neni 77, pika 2, i Kushtetutës i njeh Kuvendit kompetencën për ngritjen e komisioneve hetimore parlamentare, pikërisht për të verifikuar veprimtarinë e institucioneve shtetërore dhe përgjegjësinë e funksionarëve që ushtrojnë pushtet publik. Kur dyshimet lidhen me përdorimin e autoritetit të Kryeministrit për të detyruar dorëheqjen e një kryetari bashkie të zgjedhur drejtpërdrejt, kontrolli parlamentar merr rëndësi të veçantë. Për këtë arsye, kërkoj që Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste të iniciojë ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar, me objekt:

Verifikimin e ligjshmërisë, qëllimit dhe përgjegjësisë institucionale për transferimin dhe trajtimin tim në paraburgim, si dhe hetimin e përdorimit të autoritetit të Kryeministrit Edi Rama, drejtpërdrejt ose nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë dhe institucioneve në varësi të ekzekutivit, për të ushtruar presion mbi qëndrimin tim politik dhe institucional dhe për të më detyruar të jap dorëheqjen nga mandati i Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

Në kuadër të këtij hetimi parlamentar, kërkoj të verifikohen në mënyrë të posaçme:

1. **Ligjshmëria dhe qëllimi i transferimit** tim nga IEVP Durrës në IEVP Fier, autoritetet që e kanë urdhëruar, arsyet e vendimmarrjes dhe çdo komunikim apo udhëzim i ardhur nga Kryeministri, kabineti i tij ose përfaqësues të tjerë të pushtetit ekzekutiv.
2. **Rrethanat dhe qëllimi i vizitës së Ministrit të Drejtësisë**, më 30 tetor 2026, përfshirë autoritetin që e ka iniciuar, komunikimet paraprake, regjistrat e hyrje-daljeve dhe dokumentacionin përkatës të IEVP Fier.
3. **Përmbajtja e komunikimit të Ministrit të Drejtësisë me mua**, veçanërisht deklarimet se kërkesat dhe kërcënimet e përcjella buronin nga Kryeministri Edi Rama, si dhe verifikimi i çdo komunikimi ndërmjet tyre që lidhet me këtë takim.
4. **Përdorimi i mundshëm i transferimit dhe kushteve të paraburgimit si instrumente presioni**, përfshirë izolimin, kufizimet e komunikimit dhe pengesat në ushtrimin e të drejtave të mia, si dhe lidhja e tyre me kërkesat politike që më janë përcjellë.
5. **Roli dhe përgjegjësia institucionale e Kryeministrit dhe e funksionarëve të tjerë të përfshirë**, përfshirë burimin e urdhrave, zinxhirin e vendimmarrjes dhe përputhshmërinë e veprimeve me parimet e ndarjes së pushteteve, autonomisë vendore dhe mbrojtjes së të drejtave themelore.
6. **Lidhja vijuese ndërmjet përpjekjes së mëparshme për shkarkimin tim dhe presioneve të mëvonshme për dorëheqje**, duke shqyrtuar rrethanat e vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave, të shfuqizuar me vendimin nr. 66, datë 3 nëntor 2025, të Gjykatës Kushtetuese, për të përcaktuar nëse veprimet pasuese kanë synuar arritjen e të njëjtit rezultat përmes mjeteve të tjera, për neutralizimin tim politik.

Deklaroj gatishmërinë time për t'u paraqitur personalisht përpara komisionit hetimor parlamentar dhe për të dëshmuar nën betim, sipas ligjit, mbi të gjitha faktet dhe rrethanat që kam bërë publike.

Jam i gatshëm t'u përgjigjem pyetjeve të çdo deputeti dhe të ballafaqohem drejtpërdrejt me Ministrin e Drejtësisë, z. Toni Gogu. Kërkoj që të njëjtit standard llogaridhënieje t'i nënshtrohet edhe Kryeministri Edi Rama, për të sqaruar rolin e tij në urdhrat dhe veprimet që i atribuohen. Nuk kërkoj që Kuvendi t'i marrë të mirëqena deklarimet e mia, por t'i verifikojë ato përmes një hetimi të pavarur dhe të gjithanshëm, pa ndërhyrë në kompetencat e organeve të drejtësisë.

I nderuar z. Balla,

Këtë kërkesë ia drejtoj Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste jo për të kërkuar mbrojtje politike, por për të kërkuar ushtrimin e një funksioni themelor kushtetues të Kuvendit: kontrollin e pushtetit ekzekutiv. **Përkatësia në të njëjtën shumicë politike me Kryeministrin nuk e kufizon këtë përgjegjësi dhe as mund të shërbejë si arsye për të shmangur hetimin e veprimeve që i atribuohen atij.** Përkundrazi, kontrolli parlamentar duhet të ushtrohet pavarësisht se cila forcë politike drejton qeverinë.

Duke qenë se çështja prek edhe autonominë e një organi vendor të zgjedhur drejtpërdrejt, kam vënë dijeni Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, për shqyrtim dhe ndjekje brenda kompetencave të tyre monitoruese për zbatimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. Fakti se, një kryetar bashkie i zgjedhur drejtpërdrejt është vendosur nën kercenimin e ndjekjes penale për të hequr dorë nga mandati i tij, në kushtet e privimit nga liria, kërkon vëmendje edhe nga mekanizmat evropianë të mbrojtjes së autonomisë vendore.

Njëkohësisht, duke pasur parasysh rëndësinë e ngjarjeve objekt hetimi dhe rrezikun e humbjes, asgjësimit apo ndryshimit të provave, kërkoj që Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet mekanizmave të tij kushtetues dhe ligjorë, të ndërmarrë me urgjencë veprimet e nevojshme për t'u kërkuar institucioneve përgjegjëse ruajtjen e menjëhershme dhe të plotë të çdo prove materiale, dokumentare, elektronike dhe audiovizive që lidhet me transferimin tim nga IEVP Durrës në IEVP Fier, më 28 tetor 2026, si dhe me vizitën e ministrit të Drejtësisë, z. Toni Gogu, në IEVP Fier, më 30 tetor 2026.

Në mënyrë të veçantë, kërkoj ruajtjen e regjistrave të hyrje-daljeve, pamjeve të kamerave të sigurisë, regjistrimeve audio nëse ekzistojnë, dokumentacionit dhe urdhrave të transferimit, komunikimeve zyrtare, elektronike dhe telefonike të administruara ligjërisht, si dhe çdo dokumenti tjetër që lidhet me vendimmarrjen, organizimin dhe realizimin e këtyre veprimeve. Kërkoj që institucionet përgjegjëse të njoftohen pa vonesë për detyrimin e ruajtjes së këtyre materialeve në gjendjen e tyre origjinale, duke garantuar integritetin, gjurmueshmërinë dhe mosndryshimin e tyre, deri në administrimin nga organet kompetente, sipas ligjit.

Ruajtja e këtyre provave është e domosdoshme për garantimin e një hetimi parlamentar efektiv, të pavarur dhe të gjithanshëm. Çdo vonesë që mund të sjellë humbjen e tyre do të cenonte mundësinë e verifikimit objektiv të ngjarjeve dhe të përcaktimit të përgjegjësive përkatëse.

Me respekt,

ERION VELIAJ

Kryetar i Bashkisë Tiranë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TIRANË